



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110 – 391, t137 dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 31.3.2026, merr këtë:

V E N D I M

**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR “K.H. PRISHTINA” PËR PROJEKTIN
“K.H. PRISHTINA DREJT TITULLIT KAMPION DHE GARAVE EVROPIANE” PËR
SEZONIN 2025/2026**

- I. Miratohet Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për KH “Prishtina” për projektin “KH “Prishtina” drejt titullit kampion dhe garave evropiane” për sezonin 2025/2026.
- II. Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është **30,000.00 €** (tridhjetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kodi buxhetor i Drejtorisë së Sportit 85086.
- III. Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II. Pjesëmarrja e ekipit të parë në Superligën e Kosovës, Kupën e Kosovës dhe garat evropiane, arritjen e titullit kampion dhe zhvillimin e Akademisë së klubit, ku janë të regjistruar mbi 200 të rinj nga grupmoshat fatosë, pionerë, kadetë dhe juniorë.
- IV. Pjesë e këtij vendimi është kërkesa, projekti dhe dokumentet përcjellëse nga KH “Prishtina” dhe rekomandimi i komisionit.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë e tjera relevante.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditën pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/04-47981/26, më 02.4.2026

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina

